

SHTOJCA 2

APLIKACION PËR VAZHDIMIN E LEJËS MJEDISORE Nr. 5705/20/MMPHI (sipas udhëzimit administrativ 04/2022 dhe U adm 01.2025 për plotësimin dhe ndryshimin e UA 04/2022)	
1. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME	
1.1.Të dhënat për Operatorin	
1.1.1.	Emri i subjektit
	“ ISEFERI ” Sh.p.k.
	Vendi
	Zona Industriale Shirokë-Suharekë
	Adresa
	Zona Industriale Shirokë-Suharekë
	Nr. i tel./fax
	049 340 083
	E-mail
	iseferi2018@gmail.com
1.1.2.	Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit
	810106204
1.1.3.	Personi kontaktues për mjedis
	Ilir Hoxha
	Nr. i tel./fax
	049 340 083
	E-mail
	iseferi2018@gmail.com

1.1.4..	Personi përgjegjës kontaktues për mjedis	Ismail Seferaj Drejtor i kompanisë
	Nr.tel. fax.	044 222 808
		iseferi2018@gmail.com
1.2. Të dhënat për impiantin		
1.2.1.	Emri i impiantit	
1.2.2.	Adresa e lokacionit të impiantit	“ ISEFERI ” Sh.p.k. Zona Industriale Shirokë-Suharekë.
2.	TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT	
2.1.	Të dhënat për lokacionin ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur	“ ISEFERI ” Sh.p.k kompani e përgatitur për prodhimin e betonit dhe elementeve nga betoni , ndodhet në zonën industriale Shirokë- Suharekë . Në këtë zonë veprojnë edhe një numër i madh i bizneseve

		Harta nga Gjeoportali ku gjendet Betonara	
2.2	Nr. Kadastral i parcelës	Zona kadastrale "Suharekë", Nr. I ngastrës 02785-37 dhe 02785-36	
2.3.	Përshkrimi i lokacionit , të gjitha objektet dhe aktivitetet e tyre në atë zonë	Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokalitetit janë bazë themelore për hartimin e raportit. Hulumtimi dhe vlerësimi është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren. Për tu	

	definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për tu krijuar bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme në kuadër të gjendjes, janë prezentuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrogeologjike, hidrografike dhe meteorologjike. Bazuar në të dhënat e mësipërme, del se impianti i bazës për prodhimin e betonit do të vendoset në lokalitetin zona industriale Shirokë Suharekë afër rrugës magjistrale që lidhë Suharekën-Prizrenin në një distance rreth 1500 m(paraqitur në ortofoto) kurse nga autoudha ka një distance në vijë ajrore rreth 410 m por çasja nuk është e mundur për shkak të specifikave të njohura të autoudhës.
--	--

		
2.4	Të dhënat lidhur me florën dhe faunën në këtë lokacion	Siq shihet në orto foto , ky lokalitet është i zhveshur me një tokë të punuar rreth zonës industriale me një bimësi të ulët kryesishtë toka të punuara bujqësore. Në lokacionin ku punohet kemi të bëjmë me një degradim të florës dhe faunës mirëpo me ndërprerjen e aktivitetit

		punues në këtë lokacion kompania është e obliguar që sipas raportit të rrikultivimit , këtë lokacion ta kthej në gjendjen e mëparshme dhe ta përshtatë me ambientet rrethuese. Sa i përket faunës në këtë lokacion nuk ka diçka të veçant sepse edhe rrethina është tokë e punuar dhe nuk ka kushte që ky lokacion të strehoj kafshë të egra.
2.5.	Të dhënat mbi zonat e veçanta apo të mbrojtuna	Në këtë lokacion nuk kemi zona me status të veçant apo zona të mbrojtuna me ligj.

3. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË

3.1.Përkshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet Leja Mjedisore	
3.1.1	Skema e procesit teknologjik . Procesi teknologjik - Siloset për Çimento dycopë me kapacitet nga 60 ton dmth.2.gjithsejtë 120 ton çiment.

	- Fortina (bunkeri për fraksione, pesë ndarje me kapacitet nga $5 \times 8 \text{ m}^3 = 40 \text{ m}^3$, gjithsejtë 40 m^3, me pesë lloje fraksionesh të agregatit: +0-4mm; +4-8mm; +8+16mm; 16-22mm dhe +16-31,5mm. - Kompresori për furnizim me ajër të komprimuar ($P = 7.5 \text{ kW}$, $V = 1000 \text{ litra}$) - Peshojat automatike për matjen e agregatit dhe çimentos. - Shiriti transportues horizontal mbledhës – dozatorët - Shiriti transportues i pjerrët për furnizim me agregat, - Rezervari për aditive me kapacitet prej 1000 litra, pompa e aditivit	
--	--	--

		- Rezervarët i ujit, një rezervuar me kapacitet 1x 10000litra - Pompa me sistemin e furnizimit me ujë, - Deponia –platoja për fraksionet e agregatit. - Platot dhe shtyllat(3.70m) ku janë të vendosur silosët e çimentos - Pajimet për prodhimin e elementeve nga betoni - Gjeneratori për furnizim me energji elektrike. - Kabina komanduese e bazës së betonit, - Hapësira dhe pompa për pastrimin e automikserve , - Euro filtrat në siloset e çimentos,
3.1.2	Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik	Linja teknologjike për procesin e prodhimit të betonit. Betoniera e prodhuar nga firma prodhuese nga Turqia prodhim i vitit 2022 TIPI (AKMAKINA),, pronë e


	kompanisë “ ISEFERI ” Sh.p.k Kompania prodhon këto tipe të betonit: ▪ Betonet plastike0-16(MB 15, MB20, MB 25, MB30 MB 35, MB40) ▪ Betonet plastike0-31.5 (MB 10, MB 15, MB20, MB 25, MB30 MB 35, MB40) ▪ Beton i Ajruar 0-16(MB20, MB 25, MB30 MB 35, MB40) ▪ Beton i Ajruar 0-31.5(MB20, MB 25, MB30 MB 35, MB40 ▪ Beton rezistent ndaj ujit 0-16 (MB20, MB 25, MB30 MB 35) ▪ Beton rezistent ndaj ujit 0-31.5 (MB20, MB 25, MB30 MB 35)
--	---

	Kompania përveq këtyre llojeve të betonit mundë të prodhoj e dhe betone me karakteristika të veçanta, beton për ura , beton që përdoret nën ujë etj. • Fortina (bunkeri për fraksione, pesë ndarje me kapacitet nga $5 \times 8 \text{ m}^3 = 40 \text{ m}^3$, gjithsejtë 40 m^3, me pesë lloje fraksionesh të agregatit: +0-4mm; +4-8mm; +8+16mm; 16-22mm dhe +16-31,5mm 1. dozatori dhe peshoja e rërës gjenden të montuara në pjesën e poshtme të fortinës (bunkerit pranues) së rërës e cila punon sipas recepturës së caktuar paraprakisht nga operatori teknik.
--	--

	2. Shiriti horiz. përmbledhës , dhe bënë transportimin e rërës deri te shiriti i pjerrt transportues. 3. Peshojat automatike për matjen e agregatit dhe çimentos 4. Shiriti trans. I pjerrt 5. Hinka pranuese. Nga shiriti i pjerrt transportues, rëra bie në hinkën pranuese e më pastaj së bashku me përbërësit tjerë në U cek më lartë se peshorja e rërës në pozicionin 6. Është e vendosur në pjesën e poshtme të fortinës. 7. Uji i cili i ipet ciklit të përzierjes së betonit është i peshuar sipas recepturës së përgatitur nga operatori, prandaj sasia është e kufizuar dhe kontrollohet nga	
--	---	--

	mekanizmi i caktuar i vendosur në vend të caktuar 8.Mixer i kapaciteti vëllimor 1.5m ³ . Pompa hidraulike për hapjen e derës së mikserit: 1 x 2.2 = 2.2 [kW]
	Karakteristikat teknike të Mikserit:
	Vëllimi: 2000 [litra]
	Elektromotori:
	Fuqia 45 [kW]
	Nr. rrotullimeve: 1472 [rr/min]
	Tensioni: 380 [V]
	Frekuenca: 50 [Hz]
	cos φ: 0.87

		 Mikseri ka kapacitet prodhues prej 60 [m³/h]. Mikseri i ka të instaluar një elektro motor elektrik me fuqi prej 45 [kW]. Kapaciteti i prodhimit të kësaj linje është përafërsisht 60m³/h. Foto.1 9.transportuesit kërmillor
--	--	--

		Ky transportues kërmillorë bënë transportin e çimentos nga silosi deri te përziersi.  10. Silos I çimentos. Baza ka dy silosë vërtikal me kapacitet pranues me nga 60 t në të cilët të vendosur verikalisht , në secilin nga ta janë të tubat për thithjen e pluhurit të silët
--	--	---

kalojnë nëpër një rezervoar uji me qrast të gjitha grimcat fizike ndalen në rezervuarin e ujit duke krijuar në masë lymë i cili pastrohet në mënyrë periodike nga operatori.

12.Kompresori

 sigurimi.al



shtypja punuese është **2.5** bar kurse presioni pneumatik është **6-8 bar**

14.Shtëpia komanduese

Betonjera ka një sistem komandimi PLC dhe manual, por kryesisht punohet me PLC (sistem kompjuterik i automatizuar)

3.1.3	Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve	
		Fabrika e betonit “ ISEFERI ” Sh.p.k është punuar me dy ndrrime por tani punohet me një ndrrim me mundësi të aplikimit të orarit në dy ndrrime. fillon punën në ora 8:00 të mëngjesit deri në ora 16 dhe për 8 orë mund të prodhohen deri në mbi 500m³ beton, mirpo orari edhe mund të ndryshoj sepse mvaret nga kërkesat e klientëve dhe përgatitja e tyre , poashtu orari mvaret edhe nga sasia e betonit dhe e kubzave të porositura nga klintët. Nëse kjo sasi e kalon 500m³ , përshkak të specifikave të betonit orari l punës zgjatet por gjithnjë në marrveshje me punëtorët duke pasur

		parasyshë edhe pjesën stimulative të punëtorve kur punohet jasht orarit. Numri i të punësuarve është 43 kurse kompania nëpër njësitë tjera ka nevojë për punëtorë shtesë.
3.1.4	Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar, ditor, mujor, vjetor	Kapaciteti teorik ndryshon nga ai praktik. Nuk mundë të flitet për ndonjë projektim fiks të kapacitetit të prodhimit sepse në prodhim ndikojnë shumë faktorë. Ndër kushtet e imponuara është se betoni është prodhim i freskët i cili nuk mundë të deponohet por gjithmonë prodhohet sipas kërkesave të klientëve ,poashtu edhe për kubëzat nga betoni kushtëzohen me shije të klientëve , kjo imponon punën sipas kërkesës së klientëve. Arsyeja: Natyra e punës, pengesat e ndryshme gjatë punës. Kapaciteti praktik realizohet në masën 80 % të atij teorik, ndoshta edhe më tepër sepse pajimet makinerike janë të reja dhe bëhet fjalë për fjalën e fundit të teknologjisë. Prodhimi ditor, mujor dhe vjetor në këtë impiant variojnë sepse prodhimi varet nga shumë faktorë siç janë: 1. Gjendja teknike e impiantit 2. Nevoja apo kërkesa e tregut si dhe 3. Kualiteti i lëndës së parë.

3.1.5	Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe lendeve ndihmëse.	• Çimento • Frakcionet e gurit • Aditivë të ndryshëm • Nafta • Energjia elektrike. • Uji Frakcionet e gurit, rërës dhe zhavorrit si material bazë merren nga kompanitë prodhuese në regjion si " ISEFERI ", "CELI AG" Etj. Nafta, karburant të cilën mjetet transportuese e shfrytëzojnë si lëndë djegëse e marrin nga pika e karburantit "LAB OIL" me të cilën kompani kan marrveshje bashkëpunimi. Kompania posedon një rezervoar uji nga plastika i vendosur nën tokë në nivel të sipërfaqes punuese me kapacitet 10,000 l ujë i cila shërben edhe si deponi rezervë e ujit. Kjo rezervë e ujit do të shërbej për përgatitjen e betonit pa ndonjë pengesë, duke pasur parasysh se pusi i cili është shpuar (rreth 100 m) mundë të mos jetë i mjaftueshëm për ndonjë vëllim të madh të punëve në raste të veçanta. Të gjitha pajimet në betonjere punojnë me energji elektrike për të cilën kompania ka kontratë me KEDS-in. Uji përveq prodhimit të betonit dhe nevojave sanitare përdoret edhe për rrëzimin e
-------	--	--

	pluhurit që shkaktohet gjatë punëve nga pusi të cilin e posedon brenda objektit dhe ka sasi të mjaftueshme për nevojat e kompanisë. Kompania është e pajisur edhe me leje ujore për furnizim dhe shkarkim.
3.1.6	Lista e rezervuarve dhe kapaciteti i tyre Kompania për nevojat e saja me karburant furnizohet nga pika e karburantit “LAB OIL”.

Kompania posedon edhe rezervuar të ujit kapa. 10,000 l nga plastika dhe një kolektorë(basen) me dy ndarje i cili shërben për grumbullimin e ujrave të cilët përdoren për larjen e mjeteve të punës pas përdorimit. Ky rezervuar në mënyrëperiodike pastrohet nga lymi i deponuar të cilinmëpastaj e përdorin për mbushje sipas nevojave të klientëve.



3.1.7	Lista e legjislacionit në fuqi	Si bazë ligjore për hartimin e këtij projekti , kompania shfrytëzon këto ligje dhe udhëzime administrative. Legjislacioni në lidhje me ruajtjen e mjedisit është në përputhje me normativat evropiane të mbrojtjes së tij, ndonëse cilësia mjedisore është ende në parametra mjaft të ulët. Ligji i parë për mbrojtjen e mjedisit daton ne vitin 2003, tani i hartuar Ligji i ri për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025, në të cilin pos tjerash potencohet se të gjitha veprimtaritë e personave fizik dhe ligjor, vendas apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari të reja dhe kanë ndikime të theksuara negative në mjedis, do të jenë temë e vlerësimit të ndikimit në mjedis. Në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis – VNM është aprovuar dhe funksionon Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181 i cili përcakton te gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-
-------	--------------------------------	---

	181 ka për qëllim për të siguruar mundësimin e një vlerësimi të përgjithshëm me ndërthurje të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim të parandalimit dhe zvogëlimit apo mënjanimi të efekteve negative në mjedis në kohën e duhur. Ligjet • Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181 • Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 • Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060 • Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147 • Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110 • Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 03/L-160 • Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
--	---

	• Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26 • Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr.03/L-233 • Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102 Udhëzimet Administrative • Udhëzimi administrativ Nr.04/2022 për Lejen Mjedisore dhe UA 01/2025 plotësim ndryshimi i UA 04/2022 • Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2007 mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes • Udhëzimi administrativ për administrimin e mbeturinave të rrezikshme (06/2008) • Udhëzimi administrativ Nr. 20/2012 për export, import dhe transit të mbeturinave
--	---

	• Udhëzimi administrativ kompetencat e zotëruesit dhe operatorit për trajtimin e mbeturinave (08/2 Udhëzimi administrativ Nr. 20/2011 për Pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme • Udhëzimi administrativ Nr. 20/2011 për metodologjinë e zvogimit të rrezikut nga aksidentet kimike dhe masat për eliminimin e pasojave. • Udhëzimi administrativ Nr. 07/2012 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës. • Udhëzimi administrativ për menaxhimin e deponive të mbeturinave(15/2012) • Udhëzimi administrativ.Nr.30/2014 përkushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese te
--	--

		shkarkimit të ujrave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor.
3.2.	Menaxhimi i mbrojtjes së Mjedisit	

3.2.1.	Menaxhimi i mbrojtjes së Mjedisit	Kompania ka një kuadër profesional të të punësuarish prandaj edhe bënë një menaxhim të mbrojtjes së mjedisit. Gjat prodhimit të betonit nuk ka emitim të pluhurit në hapësirë, mirëpo për të mos ndodhur kjo kompania përdorë ujin si mjet për ta rrëzuar pluhurin . Kjo bëhet përmes tubacionit i cili është i vendosur në pjesën e sipërme të silosëve i lëshuar vertikalisht deri në fund dhe është zhytur në basenin e mbushur me ujë. Gjatë mbushjes së silosit një sasi e pluhurit përmes tubit të zhytur në ujë , kontakton ujin dhe lidhet me te e për pasojë fundërron dhe mbetet në basenin afër silosit. Kur ky basen mbushet me llym pastrohet në mënyrë
--------	--	---

	periodike , kurse materiali i nxjerrun nga baseni stivohet brenda kufinjëve të ngastrës për tu përdorur për qëllime të ndryshme sipas nevojave të kompanisë. Sipërfaqja punuese gjat sezonës së nxehtë pluhurin e rrëzon përmes spërkatjes me anë të autocisternës. E gjitha kjo monitorohet dhe raportohet nga punëtorë profesional.
3.2.2	Raportimi Kryhet nga udhëheqja dhe ekspertët e Kompanisë së bashku në fund të qdo viti kalendarik (Raporti vjetor), ku do të paraqiten të dhënat relevante nga të gjitha monitorimet e bëra brenda vitit, të cilat do të raportohen te autoritetet përkatëse në Ministri të Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë dhe komunitetin lokal të komunës.

4. AJRI	
4.1.	Pikat e burimit të emisioneve të materieve ndotëse Pika të mundëshme të burimit të pluhurit janë: 1. Shkarkimi i rrërës nga kamionët në fortinë 2. Gjatë procesit të zbrazjes së çimentos nga cisterna në silos 3. Gjatë lëvizjes së makinave operuese në repart
4.2.	Ndikimi i materjeve ndotëse në cilësinë e ajrit Duke pasur parasysh teknologjinë e avansuar në këtë objekt si dhe sistemin e filtrimit, mund të konkludojmë se pastërtia e ajrit në këtë rajon është në nivel të lakmueshëm dhe nuk ka ndonjë shkak që do të ndikonte në ndotjen e ajrit . Ndotje e ajrit ndodhë nga pluhuri i cili shkaktohet nga gazrat të cilët lirohen nga automjetet transportuse (gjatë procesit të ngarkimit dhe shkarkimit). Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër, rrugët në të cilat operon kompania duhet të spërkatën me ujë.. Në këtë

		mënyrë niveli I pluhurit në ajër bie në nivel i cili nuk paraqet rrezik për mjedisin.
4.3.	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse	Shpërndarja materjeve ndotëse siçë janë gazrat , si burime konsiderohen të jenë makinat punuese në zonën operacionale , të cilat jan pothuaj në raport të njejt me lëvizjen e makinave në rrugë.
4.4.	Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese	Paisjet për trajtimin e gazrave të liruar nga makineria në fushën operacionale duhet të kontrollohen gjat përgatitjes së makinerisë për tju nënshtruar kontrollimit teknik në fazën e regjistrimit të automjeteve.
4.5.	Pajisjet për depluhërim	Pajisje për depluhërim janë filterët e vendosur në silosë poashtu kompania për rrëzimin e pluhurit përdorë edhe ujin

		duke bërë spërkatjen e rrugës dhe hapësirave ku punohet në mënyrë periodike sipas nevojës.
4.6.	Monitorimi i emisioneve	Kompania në kuadër të betonarës posedon sistemin e filtrimit mjaftë të sofistikuar i cili mundëson një ambient krejtësisht të pastër duke bërë uljen e pluhurit deri në masë të papërfillshme. Emetimi i pluhurit do të monitorohet dhe analizohet nga Laboratori i licencuar-----, duke bërë raport të cilin do të ja bashkangjesim këti materiali plotësues. Zhurma është e papërfillshme edhe me vet faktin se nuk kemi të bëjmë me shtëpi banimi në afërsi përveq shtëpive të pronarit , zhurma nuk paraqet pengesë për zhvillimin e aktivitetit prodhues të betonit.
4.7.	Monitorimi i emisioneve të cilësisë së ajrit	Për të pasur një kontrollë mbi cilësinë e ajrit në ambientet ku punohet kompania ka bërë një raport mbi sasinë e

		pluhurit të depozituar dhe të njeitin do ti ja bashkangjesim këtë aplikacioni.
4.8	Raportimet	Nuk ka ndonjë raport të veçant
4.9.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	Për të parandaluar dhe zvogëluar sasin e ndikimeve në ajër të krijuar gjatë realizimit të punëve profesionale, nga mekanizmi për bartjen e lëndës, prodhimit, ngarkimit etj duhet të ndërmerren këto masa: ❖ Bëhet spërkatja me ujë e të gjitha sipërfaqeve operationale , rrugëve të pa asfaltuara nëpër të cilat bëhet edhe transporti i lëndës së prodhuar. ❖ Në të gjitha pikat kyqe dhe me rrezik janë vendosur aparatet kundër zjarrit. ❖ Bëhet kontrollimi i rregullt teknik i paisjeve teknologjike në mënyrë që gazrat që lirohen nga këto makina të jenë sa më pak të ndotura. ❖ Kamionët e transportit të lëndës mbulohen gjat transportit të lëndës

		❖ Kompania çdo herë, cisternën e ka të mbushur me ujë dhe të gatshme për punë.
5. UJI		
5.1.	Të dhënat për shfrytëzimin e ujit	Kompania për ti plotësuar nevojat e vete me ujë(për prodhim dhe për nyjet sanitare), ka të shpuar një pus nga i cili përmes pompës elektrike bënë nxjerrjen e ujit dhe mbushë rezervoarin me kapacitet 10000 l për ta lanë të gatshëm për nevojat e prodhimit, kurse për nevojat sanitare të kompsnisë pompa përmes sistemit të tubacionit të instaluar në objekt bënë furnizimin me ujë të objektit në mënyrë të pa ndërprerë.
5.2.	Të dhënat për shkarkimin e ujrave, shkarkimet e ujrave sipërfaqësorë apo në rrjetin e kanalizimit	Ujëra të ndotura mundë të konsiderohen ujërat e shkaktuara nga reshjet atmosferike, vajrat e ndryshme të cilat aksidentalisht derdhen në tokë nga makinat të cilat me vete bartin edhe një sasi të pluhurit të depozituar gjat kryerjes së punëve operacionale. Për tu eliminuar kjo ndotje, kompania

	këto ujra i ka kanalizuar dhe i bartë në basenat sedimentuese të tipit kaskadë Ujërat e reshjeve atmosferike Ujërat e zeza Pusi sedimentues Pusi sedimentues gropa septike Ricipienti Mostrimi ↓
5.3. Ndikimet në ujë	Ndikime negative në ujë shkaktohen nga derivatet dhe vajra e ndryshme të cilat derdhen në tokë nga makinat të cekura më lartë të cilat me derdhjen e tyre në tokë ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore, të reshurat atmosferike dhe nga ndotja e ujërave nëntokësore.

		Gjithashtu në ndotjen e ujërave ndikon pluhuri i cili bartet me anë të ujërave sipërfaqësor. Ndikimet tjera negative janë edhe derdhja e ujërave të zeza, mbeturinat e ndryshme, etj.
5.4.	Emissionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor.	Treguesit e ujërave të ndotura u cekën më lartë por nuk kemi ndonjë tregues të përhershëm sepse në ushtrimin e veprimtarive të lartëcekura nuk kemi ndotje të shkaktuara nga zhvillimi i punëve operacionale , por ajo ndotje vinte nga të reshurat të cilat janë periodike dhe na pamundësojnë që të kemi ndonjë të dhënë e cila mundë të konsiderohet vjetore.
5.5.	Trajtimi i ujërave të ndotura	Për tu eliminuar kjo ndotje, kompania këto ujra i ka kanalizuar dhe i bartë në basenet sedimentuese të tipit kaskadë.
5.7.	Raporimi	Kompania do të raporton në çdo tremujor për sasinë e ujit të shfrytëzuar gjat procesit të prodhimit
	Lejet për shfrytëzim të ujit	Kompania posedon leje ujore të shfrytëzimit

5.8		
5.9	Leje Ujëore për shkarkimin e ujërave të ndotura	Kompania posedon leje ujore për shkarkim të njejtat do ti ja bashkangjesim projektit në shtojcën grafike.
5.10	Masat për zvoglimin e ndotjes së ujërave	Për të parandaluar ndotjen e ujrave kompania ka bërë kanalizimin e ujërave në basenet sedimentues e të cilët në mënyrë periodike i pastron nga lym i depozituar me kohë të cilin kompania e përdorë për mbushje sipas kërkesës së klientëve kurse ujin e ricikluar e kthen në procesin e prodhimit.
6.	ZHURMA	
6.1	Burimet	Zhurma e shkaktuar gjatë operacionit të prodhimit nga pajimet teknologjike të agazhuara në impiant është e

		karakterit lokal dhe nuk mundë të ket ndonjë ndikim në zonat e banuara sepse në këtë zonë kemi edhe veprimtari të tjera afariste. Zhurma shkaktohet gjatë kryerjes së aktiviteteve prodhuese, nga makinat që e ngarkojnë lëndën, kamionët transportues etj. Shfrytëzimi i pajimeve bashkohore për kryerjen e punëve operacionale mundëson që zhurma në në hapsirën ku është vendosur baza për prodhimin e betonit nuk është më e madhe se . Kompania ka bërë matjen e zhurmës nga shtëpia më e afërt me impiantin dhe të njejtin raport do ja bashkangjesim aplikacionit në shtojcën grafike.
6.2	Kontroli dhe matjet	Do ta japim në formë tabelare nivelin e zhurmës në raport me distancën

		<table><tr><th rowspan="2">Zhurma</th><th colspan="4">Distanca(m)</th></tr><tr><th>10</th><th>50</th><th>100</th><th>500</th></tr><tr><td>90dB-niveli</td><td>59</td><td>45</td><td>39</td><td>25</td></tr><tr><td>Për paisje moderne</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr></table>	Zhurma	Distanca(m)				10	50	100	500	90dB-niveli	59	45	39	25	Për paisje moderne				
Zhurma	Distanca(m)																				
	10	50	100	500																	
90dB-niveli	59	45	39	25																	
Për paisje moderne																					
6.3	Raportimet	Siq u cek më lartë kjo zonë është e karakterit të përzier industrial dhe se zhurma nuk paraqet problem për rrethinën sepse edhe objektet tjera rrethuese janë objekte afariste prodhuese , prandaj kompania nuk ka nevojë për raportime të posaqme të cilat i ka bërë dhe do ja bashkangjesim aplikacionit.																			
7. TOKA																					

7.1	Ndikimet në tokë	Ndikim negativ kanë mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë mirëmbajtjes së makinerisë dhe mjeteve të transportit si dhe mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike që shkaktohen nga vet njeriu. Ndikim të madh negativ ka derdhja e vajrave lybrifikues të cilat nëse bien aksidentalisht në tokë janë të dëmshme për natyrën pasi që edhe koha e dekompozimit të tyre është e madhe. Si ndikime kemi edhe mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të mekanizmit punues, mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët.
		Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve në tokë gjat kryerjes së punëve

7.2	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	operacionale, në kompani do të ndërmerren këto masa: ❖ Masa bimore e larguar do të deponohet në vend të caktuara që të mos lejohet kalbja e tyre në mënyrë që ato të mund të përdoren më vonë.. ❖ Për ti parandaluar pasojat e erozionit do të bëjmë rikultivimin biologjik në ato pjesë ku është e mundur. ❖ Janë ndërmarrë masa që vajrat e makinave dhe të pajimeve tjera të mos derdhen në tokë. ❖ Nëse për shkak të ndonjë avarie në fazën e prodhimit duhet bërë largimi i vajit nga ndonjë makinë, atëherë duhet patur kujdes që vaji të derdhet në ndonjë enë jo
-----	--	--

	ujëlëshuese e cila duhet të vendoset nën makinën e cila riparohet. ❖ Të gjitha mbeturinat e ngurta që krijohen në lokalitet gjatë procesit të prodhimit, grumbullohen dhe të klasifikohen sipas llojit: si p.sh. ato metalike të grumbullohen në vende të posaçme e më pastaj ti shiten kompanive të licencuara për ripërpunimin e tyre kurse ato që mbeten për nevojat e Kompanisë të vendosen nëpër kontejner të veçant në mënyrë që të mos jenë shkaktar të ndotjes së ambientit. ❖ Mbeturinat e lëngëta që krijohen me rastin e ndrrimit të vajrave nëpër makina vendosen nëpër kontejner të veçant, e më pas tu jepen kompanive të licencuara të cilat merren me riciklimin e tyre.
--	---

7.3	Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit Rikultivimi i hapësirës ku është prodhuar , trajtohet në përputhje me kërkesat bashkohore të mbrojtjes dhe rikultivimit të mjedisit, të cilat trajtohen si një prioritet i rëndësishëm edhe në këtë lokalitet ku zhvillohet aktiviteti prodhues. Nga proqeset teknologjike për prodhimin e betonit do të krijohen substrate që i takojnë kategorisë së tokave të dëmtuara d.m.th substrate të pa përshtatshme për rikultivim. Substratet me përbërës të mbetjeve të betonit të degraduar, që pa tjetër duhet ti nënshtrohen rehabilitimit gjerë në masën e përmirësimit të pjesërishëm të vetive të tyre dhe krijimit ose zëvendësimit të tijë me ate të rrethinës ashtu që të krijohet një substrat produktiv i përshtatshëm për rikultivimin bujqësorë dhe ate malorë. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshinë revitalizimin në tërësi të hapësirave të shfrytëzuara dhe dëmtuara nga punimet prodhuese. Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga:
-----	---

	Qëllimi i rikultivimit- i cili ndikon që pas përfundimit të punimeve operacionale, sipërfaqeve të degraduara prapë tu kthehet funksioni i tyre primar (prodhimi i biomasës), dhe kështu zvoglohet ndikimi negativ i këtijë projekti në ekosistem. Planifikimi i shfrytëzimit të tokës-planifikohet që toka në lokalitetet e prodhimit të betonit të rikultivohet duke iu përshtatur gjendjes së përafërt me atë të rrethit. Rikultivimi është i lidhur me aktivitetet prodhuese, përkatësisht përfundimin e punëve dhe shpalljen e zonës operative të mbyllur. Të gjitha aktivitetet e lartëshënuara synojnë objektivat e rikultivimit që kanë këto qëllime: ❖ Prodhimin e biomasës ❖ Rehabilitimin e peisazhit dhe kthimin e pamjes vizuele në harmoni me formën relëfore të terrenit.
--	--

	❖ Kthimin e profilit pedologjik të tokës së degraduar me rastin e punimeve operationale. ❖ Zgjërimi i kapacitetit filtrues natyror të ajrit. ❖ Mveshja i sipërfaqeve gjvëshura si pasojë e punimeve operationale. ❖ Krijimin e një pejsazhi të bukur, të përafërt me atë të natyrës për rreth.
--	---

8. MENAXHIMI I MBETURINAVE	
8.1	Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi sipas katalogut shtetëror të mbeturinave Natyra e punës është e tillë e cila nuk mbeturina të cilat do të ishin me rrezik për mjedisin. Si mbeturinë mundë të kualifikohet materiali i dëmtuar(betoni, kubëzat) , të cilat ndahen ,stivohen(palohen brenda hapësirës së lokacionit ku zhvillohet aktiviteti prodhues) sepse në të kundërtën ato do të bëheshin pengesë për zhvillimin e punëve operationale për prodhimin e betonit dhe

		kubzave nga betoni. Ky plan është i bazuar në selektimin , klasifikimin sipas llojit dhe deponimit të mbeturinave të cilat kohë pas kohe u jepen klientëve për mbushjen e platove të ndryshme për qëllime afariste.
8.2	Përshkrimi i magazinimit apo deponimit të mbeturinave	• Mbeturinë në betonjere konsiderohet edhe materiali tepriçë që kthehet nga klientët, i cili është me sasi të vogël, por i njëjti nuk ka nevojë për magazinim sepse ky material vedoset (stivohet) në një pjesë të zonës së licencuar dhe në mënyrë periodike mundë të kërkohet nga kompanitë tjera si material për mbushje. Material tjetër që mundë të konsiderohet si mbeturinë janë edhe pjesët e ndrrimit (të pa përdorshme) të cilat ruhen në kontajner të posaçëm nga metali, vajrat lybrifikues të ndërruara etj të cilat u dorëzohen

		kompanive të licencuara për trajtim të mëtutjeshëm profesional sipas ligjeve në fuqi (Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060), kompania bënë ndarjen dhe klasifikimin e mbeturinave.
8.3	Përshkrimi për trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave	Përveq vajrave të ndërruara në makina të cilat ua dorëzon kompanive të tjera për trajtim të mëtutjeshëm , kompania nuk bën riciklim të mbeturinave sepse nuk merret me mbledhjen e mbeturinave.
8.4.	Dërgimi për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër-kontratë me kompaninë e Licencuar	Kompania "I. SEFERI" nuk është kompani e cila bënë pranimin e mbeturinave nga jashtë, por mbeturinat të cilat krijohen gjat zhvillimit të punëve operacionale I

		klasifikon sipas llojit dhe l deponon në vende të caktuara deri sa nuk l dorzon në kompanitë e licencuara që merren me riciklimin e tyre (Vajrat e ndërruara) .
8.5.	Plani për menaxhimin e mbeturinave	kompania “ ISEFERI ” bënë ndarjen dhe klasifikimin e mbeturinave të ngurta të cilat mundë të jenë beton l betur gjat procesit të prodhimit. Këto mbetje kompania l stivon (sistemon) në një vendë të caktuar që nuk paraqet pengesë për punët operationale të kompanisë dhe kohë pas kohe l përdorë për mbushje sipas kërkesave të konsumatorëve. Duhet pasur parasyshë se ky lloj l mbetjeve të ngurta është l vogël në sasi dhe nuk paraqet problem për menagjimin e tyre.
	Raportimi	-----
9. RREZIKU NGA AKSIDENTET		
9.1.	Plani për pengimin e aksidenteve në rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm	

	Aktiviteti i bazës së betonit, linjës për prodhimin e kubëzave nga betoni dhe mekanizmi punues është i mirëmbajtur si dhe nën mbikqyerjen e stafit profesional që punon në kuadër të kësaj kompanie. Pasi në lokalitetin ku prodhohet betoni dhe kubëzat nuk kemi të bëjmë me materie të rrezikshme për mjedisin, atëherë rreziqet e mundshme që mund të ndodhin në vend pune mund të jenë të natyrës së ndryshme gjatë proceseve teknologjike si: ❖ Gjatë procesit të mbushjes së autocisternës me ujë. ❖ Gjatë transportit të frakcioneve nga kompanitë e ndryshme ❖ Gjatë riparimeve dhe mirëmbajtjes ❖ Gjatë shkarkimit të çimentos në silos nga cisterna. ❖ Gjatë palosjes (paletimit të kubëzave)
--	--

9.2.	Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre	Puna operacionale në kompaninë “ ISEFERI” Sh.p.k. nuk bazohet në materije të cilat mundë të kualifikohen si të rrezikshme.
9.3.	Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave	Për evitimin e rreziqeve nga aksidentet gjat prodhimit të betonit duhet: ❖ Është bërë plani i mbrojtjes nga zjarri. ❖ lokaliteti i fabrikës është i thurur. ❖ Jan marrur të gjitha masat e sigurisë në përputhje me ligjin për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punëtorëve dhe mjedisit në punë.
9.4.	Raporti mbi gjendjen e sigurisë	Për monitorimin dhe raportimin e ndikimeve direkte të aktiviteteve prodhuese, të proqeseve teknologjike, duke u bazuar në vlerësimet e ndikimit në mjedis të cilat janë ndikimi në tokë, në ajër dhe ujë të cilat do të ishin minimale pas marrjes së masve për zvogëlimin e këtyre ndikimeve.

		Për këtë arsye parashihet një program monitorues për për të raportuar mbi gjendjen e sigurisë lidhur me prodhimin e betonit dhe kubzave nga betoni. Monitorimi i ajrit, ujit dhe zhurmës bëhet me marrjen mostrave dhe kryerjen e analizave në institute adekuate dhe të raportohen në ministri të mjedisit dhe planifikimit hapsinorë sipas kërkesës së tyre.
9.5.	Plani për mbrojtjen nga zjarri	● Ambientet e kompanisë “ ISEFERI” janë të pajisura me aparatet për shuarjen e zjarreve si preventivë në rast të ndojë aksidenti . Për shuarjen e zjarrit të përdoren aparatet mobile zjarfikëse janë të vendosura në vendet ku do të jenë më efikas psh. në hapësirat ku gjendet lëndët djegëse (nafta, vajrat lybrifikues) dhe ne hapësirat ku mbahen mbeturinat nga letra, si dhe ne hapësirat prodhuese. Zakonisht vendosen dy

	aparate mobile zjarrfikëse të tipit (S9) dhe një arkë me rërë. • Është i rregulluar sistemi pajisjeve kundër zjarrit me anë të ujit dhe të sigurohen aparatet me mjete kimike si dhe enët me rërë. • Rezervuari i naftës është i mbrojtur nga ndikimet e jashtme • Shiritat transportues janë siguruar me rrethoja metalike anësore. • Oborri i fabrikës është i thurur mirë nga të gjitha anët dhe i kontrolluar mirë 24 orë/ditë me qëllim të minimizimit të paraqitjes së ndonjë aksidenti të mundshëm.
--	--

		 Aparat për shuarjen e zjarrit, 5kg dioksid karboni
10. MASAT NË RASTET E PUNES JO STABILE TË IMPIANTIT		
10.1.	Ndërprerja momentale e punës së impiantit	Ndërprerja momentale të punës mundë të krtë përshkak të mungesës së energjisë elektrike , defekteve të papritura etj.
10.2.	Ndërprerja e punës	Te ndërprerja e punës mundë të vi përshkak të mosrespektimit të detyrimeve që dalin nga ligjet e lartëcekura në fuqi apo edhe për afarizëm jo të sukseshëm të kompanisë.
11. Ndikimi i mundshëm i ndotjes në shëndetin e njeriut		

- Në rast të mos funksionimit të sistemit të (filterëve) të depluhërimit , në betonjere sistemi i spërkatjes me ujë, konsiderohet si alternativë e mundshme rrëzimin e pluhurit. Bëhet mbikëqyrje e rregullt dhe menaxhim sa më i mirë gjatë procesit të prodhimit të betonit dhe të kubzave.
- Ndalohet deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve nga mbeturinat , si mbeturinat e rrezikshme në mënyrë të pakontrolluar në hapësirat e kompleksit të betonjerës dhe linjës për prodhimin e kubzave që nuk janë të dedikuara për deponimin e tyre .
- Ndalohet dhezja e mbeturinave të lëngëta dhe të ngurta brenda lokacionit.
- Pronari është i detyruar të mbanë evidencën dhe ruan shënimet për dërgimin e tyre në qendrat e licencuara për riciklim, për sasinë dhe llojin e mbeturinave të seleksionuara, dhe sasinë dhe llojin e mbetjeve nga mbeturinat, me qëllim që të vërtetohet dalja e mbeturinave në këtë lokacion(vendi për grumbullimin e mbeturinave).
- Evidenca dhe shënimet duhet të mbahen sipas rekomandimeve që jepen në Ligjin për Mbeturina Nr. 02/L-30 dhe Udhëzimeve administrative për mbeturina relevante të hartuara sipas rekomandimeve nga Ligjin për Mbeturina Nr. 02/L-30.

Personi pergjegjes per mjedis
Ilir Hoxha

Nenshkrimi



Personi pergjegjes i kompanise
Ismail Seferaj

Nenshkrimi



RAPORTIMI I REZULTATETEVE TË TESTIMIT
NR. 017/2026

LABORATORI I CILËSISË SË AJRIT

PR-7.8



Klienti:

ISEFERI SHPK

Magj. Suharekë-Prizren, Gjinoc
20000, Prizren

Laboratori:

"YLLKA A. SHALA" B.I.

Zona Industriale, Shirokë
23000 Suharekë

R A P O R T

Matja e Pluhurit Total në ambientet e jashtme te
OE "ISEFERI" SHPK, Suhareke

"YLLKA A. SHALA" B.I. – Shërbime Fushore dhe Laboratorike
Maj 2026

Tabla nr. 1 Të dhënat e përgjithëshme

Kërkesa me nr. 045/2026 nga OE	„ISEFERI“ SH.P.K. Suharekë
Adresa	Magj. Suahrekë- Prizren, Gjinoc
Personi kontaktues	Ilir Hoxha +383 49 340 083
Email adresa	Iseferi2018@gmail.com
Data e realizimit të matjeve	05/06.05.2026
Matjet janë realizuar nga	Sektori i cilësisë së ajrit
Data e dorëzimit të mostrave në laborator	06.05.2026
Data e analizave	06.05.2026
Data e përfundimit të analizave	06.05.2026
Data e raportimit	07.05.2026



MATJA E PERQENDRIMIT TE GRIMCAVE TE NGURTA NE AMBIENT

- Matja e përqendrimit të grimcave të ngurta është bërë në hapësirat ku zhvillohet veprimtaria e zinkimit të konstruksioneve të metalit në kompaninë **ISEFERI SHPK** – e cila gjendet në zonë industriale në fshatin Petrovë të Prizrenit.

- Mostrimi është bërë me anë të pajisjes **CCZ-30** pajisje statike automatike, niveli i lartësia gjatë matjes 1.8 m mbi sipërfaqe të tokës për kohën 24 orësh, pajisje e cila është në përpushmëni me kërkesat e metodës standarde BS ISO 12341:2023 bazuar në teknikën analitike të gravimetrisë, për matjet gravimetrike është përdorë peshorja analitike elektronike OHAUS PIONEER.

Tabela 2. Koordinata e lokacioneve të matjeve

Pika e matjes	Koordinatat	PT*/24 orë	PT/30 dite	Normativi VK**
Ne sipërfaqen e jashtme të betonieres	42°20'41.51"N 20°47'50.84"E	0.288 mg/m ³	8.64 mg/m³	30 mg/m ³
Te dhënat të tjera				
Orari i punës	Nga	08:00	Deri në	16:00
Data e monitorimit	05-06/05/2026	Kohëzgjatja e monitorimit	24 h	
PT filtri nr.	017		Fillimi 05 05 26	08:40
			Mbarimi 06 05 26	08:40

*VKM-Vlera Kufitare Maksimale sipas UA 07/2021 MMPHI

PT-Grimcat e ngurta totale

- Rezultatet vlejné për matjet e bëra në kohën e dhënë në këtë raport.
- Raporti nuk lejohet të fotokopjohet pa lejen e laboratorit.



Figura 3. Ambienti i jashtëm



Figura 4. Peshorja Analitike Elektronike OHAUS PIONEER



Figura 5. Lokacionet e matjes se grimcave te ngurta

Mbi akreditimin e laboratorin per fushën e caktuar e gjeni ne linkun e poshtëm, duke iu referuar tabelës se pametrave të cilët janë brenda fushës së akreditimit.

<https://dak.rks-gov.net/desk/inc/media/2FEC191A-969C-4476-A9AB-F81361864F04.pdf>

Menaxher i cilësisë: Yllka Shala



	RAPORTI I REZULTAEVE NR. 005/2026	PR-7.8	
	Laboratori Testues për Ambient	ver. 1.0 page 1 to 5	

Për: ISEFERI SHPK

Magj. Suharekë-Prizren, Gjinoc
20000 Suharekë

Nga: “YLLKA A. SHALA” BI

Rr. “Zona Industriale”
23000 Suhareke

R A P O R T


MATJA E ZHURMES NE HAPSIRAT E JASHTME TE KOMAPNIS
ISEFERI SHPK

Maj 2026

	RAPORTI I REZULTATEVE NR. 005/2026	PR-7.8	
	Laboratori Testues për Ambient	ver. 1.0 page 2 to 5	

Tabla nr. 1 Të dhënat e përgjithëshme

Kërkesa me nr. 045/2026 nga OE	„ISEFERI“ SH.P.K. Suharekë
Adresa	Magj. Suahrekë- Prizren, Gjinoc
Personi kontaktues	Ilir Hoxha +383 49 340 083
Emal adresa	lseferi2018@gmail.com
Data e realizimit të matjeve	05/06.05.2026
Matjet janë realizuar nga	Sektori i cilësisë së ajrit
Data e raportimit	07.05.2026



Përshkrimi i aktiviteteve

Këto matje të zhurmës mjedisore janë kryer bazuar në kërkesën z. Ilir Hoxha përgjegjës për çështje mjedisore në OE "ISEFERI" SHPK. Kompania merret me prodhimin e elementeve të betonit e cila gjendet në rrugën Industriale në Shirokë-Suharekë.

Këto matje u realizuan me datën 05 maj 2026 në prezencën e përgjegjësit të mjedisit si dhe në kohën kur të gjitha aktivitetet ishin në zhvillim e sipër.

Matjet e zhurmës janë kryer sipas metodologjisë bazuar në nenin 6 të Ligjit mbi mbrojtjen nga zhurma në Republikën e Kosovës nr.02/L-102 si dhe udhëzimit administrativ nr. 08/2009 Republikës së Kosovës. Kushtet atmosferike ishin komfort kërkesave të ligjeve në fuqi ku shpejtësia e Erës ishte 0-1 m/s dhe Temperaturat e Ajrit 13-15 °C dhe lagështia e Ajrit ishte 64%. Kohëzgjatja e matjeve është bërë në çdo pikë matëse nga 10 minuta, përderisa pozita e pikave janë përzgjedhur sipas pozitës së aktiviteteve të OE edhe atë në 4 lokacione të ndryshme ku ishte mundësia më e madhe që të ketë nivel më të lartë të zhurmës (shih figurën 1). Lloji i zhurmës ishte e njëtrajtshme por që pajisjet punonin sipas nevojë dhe zakonisht orari i punës ishte nga ora 8:00 deri në ora 16:00.

Tabela 1. Pajisjet të cilat janë përdorur për matjen e zhurmës dhe shpejtësisë së erës

Lloji i Matjes	Pajisja	Modeli
Zhurma	TOPTTEST	TS-501B
Shpejtësia e Eres	TOPTTEST	TS-301
Lagështia e Ajrit	TESTO	608-H1

Rezultat e matjes së zhurmës në 4 lokacione

Tabela 2. Rezultate të matjes së zhurmës rreth e përfaqësojë Objektin e Galvanizimit të metaleve.

Nr.	Lokacionet- Pikave matëse	Vlera e matur (në dB)	Vlera e lejuar (në dB)	Vlerësimi
1	ISEFERI_ZH1	58.3	75	E lejuar
2	ISEFERI_ZH2	66.1		E lejuar
3	ISEFERI_ZH3	61.7		E lejuar
4	ISEFERI_ZH4	55.2		E lejuar

Vërejtje: Këto vlera të matur vlejnë vetëm për kohën sa është bërë matja e zhurmës

Periudha kohore e matjes së zhurmës: nga ora 08:45 deri në 09:55



Tabela 3. Lokacionet e matjes se zhurmës dhe koordinatat

Lokacioni	Koordinata X	Koordinata Y
ISEFERI_ZH1	42°20'41.55"N	20°47'50.83"E
ISEFERI_ZH2	42°20'43.45"N	20°47'50.06"E
ISEFERI_ZH3	42°20'43.44"N	20°47'52.35"E
ISEFERI_ZH4	42°20'42.11"N	20°47'52.83"E



Figura 1. Te 4 lokacionet e matjes se nivelit te zhurmës



Shënim:

Duke u bazuar në vlerat e matura te paraqitura në tabelën nr.2, të dhëna në këtë Raport mund të konstatojmë se:

Vlerat e matura të zhurmës janë nën nivelin e vlerave kufizuese (te lejuara) kjo sipas udhëzimit administrativ nr. 08 /2009 te Republikës se Kosovës.

Tabela 3. Lokacionet e matjes se zhurmes dhe koordinatat

Lokacioni	Koordinata X	Koordinata Y
ISEFERI_ZH1	42°20'41.55"N	20°47'50.83"E
ISEFERI_ZH2	42°20'43.45"N	20°47'50.06"E
ISEFERI_ZH3	42°20'43.44"N	20°47'52.35"E
ISEFERI_ZH4	42°20'42.11"N	20°47'52.83"E




Figura 1. Te 4 lokacionet e matjes se nivelit te zhurmës

Shënim:

Duke u bazuar në vlerat e matura te paraqitura në tabelën nr.2, të dhëna në këtë Raport mund të konstatojmë se:

Vlerat e matura të zhurmës janë nen nivelin e vlerave kufizuese (te lejuara) kjo sipas udhëzimit administrativ nr. 08 /2009 te Republikës se Kosovës.

Menaxheri i Cilësisë: Yllka Shala





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM) në pajtim me nenin 6, 39, 40, 59 dhe 62 të Ligjit për Minierat dhe Minalet nr. 03/L-163 si dhe Ligjin nr. 04/L-158 Për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minalet, në mbledhjen e mbajtur me datën 20/11/2025, lëshon këtë:

Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale (NCRM) u skladu s članom 6, 39, 40, 59 i 62 Zakona o Rudnicima i Mineralima br. 03/L-163 kao i Zakona br. 04/L-158 za Promene i Dopune Zakona br. 03/L-163 za Rudnike i Minerale, na održanoj sednici sa datumom 20/11/2025, izdaje ovo:


Independent Commission for Mines and Minerals (ICMM) in accordance with article 6, 39, 40, 59 and 62 of the Law on Mines and Minerals no. 03/L-163 and the Law no. 04/L-158 on Amending and Supplementing the Law no. 03/L-163 on Mines and Minerals, in the meeting held on 20/11/2025, hereby issues this:

LEJE PËR AKTIVITETET E VEÇANTA
DOZVOLE ZA POSEBNE AKTIVNOSTI / SPECIAL OPERATIONS PERMIT
1009/KPM/2026

Emri i Biznesit / Naziv Biznisa / Name of Business:	ISEFERI SH.P.K.
Nr. i Biznesit / Br.Biznisa / Business No:	810106204
Nr. i Regjistrimit / Br.Registracije / Registration No:	1495
Pronar i Biznesit / Vlasnik Biznisa / Business Owner:	Habib Seferaj; Behar Seferaj; Ismail Seferaj
Kohëzgjatja / Trajanje / Duration:	15/12/2028
Sipërfaqja / Površina / Surface area:	54436.53 m ²
Emri i vendit / Ime mesta / Site name:	Zona Industriale Shirokë
Leje për / Dozvola za / Permit for:	
Komuna / Opština / Municipality:	Suharekë
baza e betonit / osnova za beton / concrete base	

Të drejtat dhe detyrimet / Prava i obaveze / Rights and obligations:

- Kompania obligohet që t'i përmbahet kushteve të kësaj Leje dhe obligohet të përmbush detyrimet sipas nenit 41 të Ligjit për Minierat dhe Minalet nr. 03/L-163 si dhe me Ligjin nr. 04/L-158 Për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minalet.
- Kompanija je dužna da se pridržava uslova ove Dozvole, i zadužuje se da ispuni svoje obaveze iz člana 41 Zakona o Rudnicima i Mineralima br. 03/L-163 kao i Zakona br. 04/L-158 za Promene i Dopune Zakona br. 03/L-163 za Rudnike i Minerale.
- Company is obliged to comply with the terms of this Permit and is obliged to fulfil its obligations under article 41 of the Law on Mines and Minerals no. 03/L-163 and the Law no.04/L-158 on Amending and Supplementing the Law no. 03/L-163 on Mines and Minerals.



Kryesues i Bordit/ Predsednik Odbora/ Chairman of the Board

Dr. Habib Basholli

Nr. Prot / Br. Prot / Prot. No:

185

Datë / Datum / Date:

29.01.2026

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVË	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Mjedisim: Ore leshim: Grafik: No. Hapësirë: Dr. Struktura: No. Pajisje:	57-02 5705-2/20 -01- 06.09.21 PRISHTINË / A No. 1



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	07.06.2021
REFERENC-Ë:	5705/20/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"I Seferi" SH.P.K. Gjinoc- Suharekë Bazë për prodhimin e betonit dhe produkteve nga betoni në Shirokë - Suharekë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të kompanisë "I Seferi" SH.P.K. Gjinoc- Suharekë, me nr. prot. 5705/20/MMPHI, të datës: 09.12.2020.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, bien vendimin i cili i bashkëngjitet kësaj letërpërcjellëse së bashku me Shtojcën:

1. Vendimi për Leje Mjedisore për kompaninë "I Seferi" SH.P.K. Gjinoc- Suharekë, për bazën e prodhimit të betonit dhe produkteve nga betoni në Shirokë - Suharekë.
2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 dhe Udhëzimi Administrativ për Leje Mjedisore Nr. 07/2017.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025, si dhe dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 07/2017 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Kompania "I Seferi" SH.P.K. Gjinoc- Suharekë, pajiset me Leje Mjedisore për bazën e prodhimit të betonit dhe produkteve nga betoni në ngastrat kadastrale: nr. P- 72116046-02785-36, P- 72116046- 02785-37, zona kadastrale, Shirokë - Suharekë.

Operatori obligohet:

- Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
- Vlerat e cilësisë së ajrit dhe zhurma të jenë në nivelin e lejuar sipas legjislacionit në fuqi;
- Raporti i rezultateve të cilësisë së ajrit dhe zhurmës, sipas dinamikës së përcaktuar me legjislacion të dorëzohet MMPHI-së;
- Ujërat që përdoren për proces teknologjik të kthehen në proces, përmes sistemit ri qarkullues;
- Sistemi ri- qarkullues i ujit jetë funksional;
- Kontejnerët me aditiv të mbahen në vaska speciale;

- Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI-në;
- Për sistemin menaxhues mjedisore të këtij personin e profilit inxhinierik që është përgjegjës për mjedis;
- Pas përfundimit të veprimtarisë, operatori është i obliguar të kthej lokacionin në gjendjen e mëparshme.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për kompaninë "I Seferi" SH.P.K. Gjinoc-Suharekë, për bazën e prodhimit të betonit dhe produkteve nga betoni në ngastrat kadastrale: nr. P- 72116046- 02785-36, P- 72116046- 02785-37, zona kadastrale, Shirokë - Suharekë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, komfor nenit 31 paragrafi 2. të Ligjit për Mbrojtje e Mjedisit Nr. 03/L-25 dhe Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore nr. 07/2017.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes së tij.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 20/5705/ZSP/ /21 datë: 07.06.2021.

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komunës
3. DMMU-së
4. Inspektoratit
5. Kabinetit të Ministrit
6. Arkivit të MMPHI-së



Izëdin Bytyqi

Sekretar i Përgjithshëm

Faqe 3 nga 3

REPUBLIC OF KOSOVO - PLANA QENDRORE - GOVERNMENT OF KOSOVO
 REPUBLIKA E KOSOVES - PLANA QENDRORE - QEVERIA E KOSOVES
 MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPESINOR
 MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
 MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

Shifra e dokumentit: 50-02
 Nr. i dokumentit: 2338-2/19
 Data: 23.07.19
 Prishtine / a



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	18.07. 2019
REFERENC-Ë:	19/2338/2-331/DMMU
PËR/ZA/TO:	"ISEFERI" Sh.p.k. Suharekë, Gjinoc.
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

